



NGA: Njësia për Komunikim dhe Informim me Publikun

PËR: Kryetarin e Komunës, EKREM KASTRATIN

LËNDA: Raporti Vjetor i Punës për vitin 2024

DATË: 3.01. 2025

NR. I PROT 01/01

Detyrat e dhëna:

- 1. Përcjellja e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve dhe organizmave tjerë komunal.**
- 2. Informimi i medieve për vendimet e marra në Kuvend dhe Këshill të Drejtorëve**
- 3. Udhëheqja e shërbimit të informimit publik.**
- 4. Informimi i organeve komunale, lidhur me shkrimet në media**
- 5. Reagimi ndaj shkrimeve tendencioze.**
- 6. Përgatitja e Buletinit mujor dhe vjetor, lidhur me informacionet dhe ngjarjet që kanë ndodhur gjatë muajit dhe vitit në komunën tonë.**
- 7. Mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare të komunës.**
- 8. Punë dhe obligime të tjera në bashkëpunim me udhëheqësit komunal.**
- 9. Informimi paraprak për ngjarjet në komunë.**

- Nga obligimet dhe takimet e shënuara në detyrat e dhëna, kemi përgatitur informacione për medie, dhe pothuajse të gjitha janë publikuar në mediet elektronike dhe të shkruara, përfshirë radio dhe televizionet lokale TV Malisheva dhe RTV Malisheva, Radio "Kosova e Lirë", radiotelevizionin publik, televizionet tjera dhe portalet informative.

- Po ashtu, të gjitha informacionet janë bërë publike edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Malishevës: <http://kk.rks-gov.net/malisheve/> , si dhe në rrjetet sociale.

- Një punë tjetër e Zyrës për Informim Publik, është ruajtja e artikujve të botuar në gazetat ditore, për të cilat, çdo drejtor apo zyrtar komunal, mund ti shfletoj në Zyrën për Informim, por edhe të ketë kopje të tyre.

- Në mënyrë të rregullt përgatitet Buletini Mujor, i cili është i publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, si dhe arkivohet në arkivin e komunës.

- Për të gjitha aktivitetet mujore, informohen mediet dhe njoftime bëhen publike në ueb faqet zyrtare.

Aktivitetet dhe publikimet

Gjatë periudhës janar- Dhjetor të vitit 2024, janë zhvilluar 834 aktivitete të ndryshme, ku përfshihen përcjellja e aktiviteteve të kryetarit, drejtorëve komunal dhe zyrtarëve tjerë. Prej këtyre aktiviteteve, janë aktivitete të kryetarit dhe qeverisë komunale, ku përfshihen takimet në zyrat përkatëse, vizita në terren, takime me qytetarë dhe të tjera, ku janë bërë 642 lajme, 73 njoftime, shpallje dhe (konkurse 12,) 12 buletin (Janar- Dhjetor 2023), si dhe janë publikuar dokumente ku përfshihen, : kontratat 71, plane pune dhe raporte pune, Rregullore 1, dhe vendime të kryetarit-të publikuara 384 vendime të Kuvendit të Komunës, 141 procesverbale të KK 1, mbledhje të kuvendit, 7 të rregullta, 2 solemne, 2 të jashtëzakonshme 2, urgjente 2, procesverbale të Komitetit për Politikë, 6 mbledhje të rregullta , 2 të jashtëzakonshme 1 urgjente, 24 konsultime publike, debate me qytetarë, dëgjimet publike të kryetarit 2, kurse, drejtorisë për buxhet dhe financa, rregulloreve me pjesëmarrëje të grupeve të interesuara, po ashtu janë thirrur takimi dhe janë mbajtur, ku përfshihen 4 takime të kryetarit të komunës, 2 rregullore, 1 plan pune dhe 4 dëgjime për hartimin e buxhetit të komunës, për vitin 2024/2027. Në këto takime kanë marrë pjesë 89 pjesëmarrës janë mbjtur edhe 2 takime publike me qytetarë të organizuara nga zyra e kryetarit. 17 kërkesa në Qasjen për Dokumente Publike, prononcime publike për medie nga zyrtari për informim, e po ashtu edhe nga kryetari i komunës, 43 aktivitete të komiteteve dhe komisioneve janë përcjellur. Të Enjtën, pritja e palëve ka vazhduar me kryetarin.

Bazuar në këto të dhëna, Zyra për Informim Publik, ka kryer më shumë se tetë aktivitete të ndryshme, brenda një dite, pa e llogaritur këtu edhe daljet në terren dhe punën jashtë orarit. Sipas nevojës, është punuar edhe jashtë orarit të punës, përfshi edhe ditët e vikendit apo ditët e festave zyrtare.

Gjithashtu, ueb faqja e Komunës së Malishevës, është freskuar në vazhdimësi, sidomos linqet e lajmeve, njoftimeve dhe publikimi i dokumenteve, sipas nevojave dhe kërkesave të zyrave përkatëse.

Malishevë, 3 janar 2025

Njësia për Komunikim me Publikun

Udhëheqësi, Ma.sc. Izet Shala